

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Drejtoria e planifikimit te territorit dhe zhvillimit urban pranë Bashkisë Lezhë ndahet në 2 (dy) sektorë:

1. Sektori i hartimit te projekteve.

Nen/sektori I hartimi te projekteve ka per qellim të hartojë projekte te cilat sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm ne territorin e Bashkisë Lezhe, garantimin e vazhdimesise se projekteve prioritare dhe nxitjen e zhvillimit social dhe ekonomik.

- Perzgjedhja e projekteve realizohet pas nje analize te plote me sistem pikezimi. Perzgjedhja e projekteve fillon nga takimet dhe kerkesat ne komunitet, si dhe prioritet e bashkise Lezhe ne permiresimin e kushteve per qytetaret e saj.
- Projektet qe pastaj financohen nga Bashkia Lezhe,jane kryesish projekte ne permiresimin dhe krijimin e infrastrukturave, permiresimin dhe krijimin e objekteve shkollore, social-kulturoreetj.
- Ushtrimi i kontrollit për zbatimin e projekteve te financuara eshte I perhershem dhe i vazhdueshem.

Baza ligjore

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- Ligji nr.107/2015, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
- Vendimi i KKT-së nr. 6, datë 16.10.2017, “Për miratimin Planit Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhe”.
- Vendim i KKT-së Nr.1, datë 22.08.2014, “Për harmonizimin e instrumenteve të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrative-territoriale”
- VKM nr.408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.
- Vendim i KKT-së nr.5, datë 29.12.2014, “Për idendifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”.
- VKM nr.860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”.
- Ligji nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave “.